



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR MBROJTJEN E
FËMIJEVE 2026-2030 PËR BASHKINË KAMËZ**

I mbajtur më 27.02.2026, në orën 11:00, në dëgjese me banorët e Bashkisë Kamëz, në lidhje me konsultimin e Planit Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve për vitet 2026-2030, për Bashkinë Kamëz. Takimi u zhvillua në Sallën e Rinisë, Pallati i Kulturës “Artan Cuku”.

Të pranishëm në takim ishin:

- Pergjegjës i Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtoria e Ndhjes Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj. Eralda Allushi;
- Specialist i Mbrojtjes së Fëmijëve, Drejtoria e Ndhjes Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, znj. Bleona Manjani;
- Specialiste Psikologe, Drejtoria e Arsimit Rinisë dhe Sportit, znj. Arjola Topalli;
- Efektiv i Policisë në Komisariatit Nr5. z.Arben Zalla;
- Infermjere në Qendrën Shendetësore Kamëz, znj. Besonta Rexhmati;
- Grupi i Punës;
- Banorë të Kamzës.

Takimin e hapi Pergjegjësja e Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve, znj.Eralda Allushi, e cila pasi falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, theksoi rëndësinë e procesit të konsultimit publik si një instrument i domosdoshëm për garantimin e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së komunitetit në hartimin e politikave vendore.

Në vijim, znj.Allushi prezantoi Planin Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve 2026–2030, duke nënvizuar se ky dokument strategjik përfaqëson angazhimin institucional të Bashkisë Kamëz për të forcuar sistemin vendor të mbrojtjes së fëmijëve, për të parandaluar dhe adresuar në mënyrë efektive çdo

formë rreziku, si dhe për të garantuar respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare.

Gjatë prezantimit u theksua se Plan i Vendor i për Mbrojtjen e Fëmijëve 2026–2030 është hartuar nga Grupi i Punës i ngritur nga Bashkia Kamëz, mbi bazën e analizës së situatës vendore, nevojave të identifikuar dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, me synimin për të siguruar ndërhyrje të koordinuara, shërbime cilësore dhe mekanizma funksionalë referimi në mbrojtje të çdo fëmije.

Gjithashtu znj. Allushi theksoi se Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm institucionalë dhe organizata jofitimprurëse, ka ofruar shërbime të vazhdueshme për rastet e menaxhuara, ndër të cilat përfshihen:

- Ndiurma Ekonomike;
- Mbështetje financiare për raste të veçanta nga fondet e bashkisë;
- Bonus për subvencionimin e qirasë ose interesave të kredisë;
- Këshillim psikologjik dhe ligjor;
- Ndërmjetësim për punësim;
- Mbështetje me pako ushqimore dhe higjieno-sanitare;
- Pajisje elektroshtëpiake;
- Përfshirje në kurse profesionale;
- Shërbim lëvizës;
- Transport social.

Më pas Pergjegjësjë e Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve, znj. Eralda Allushi prezantoi objektivat e Planit Vendor për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe rezultatin e pritshëm gjatë zbatimit të Planit.

❖ **Prezantimi i objektivave specifike të planit**

O1. Funksionalizimi i plotë i strukturave vendore të koordinimit dhe referimit (PMF, NJMF, mekanizmat ndërinstitucionalë).

O2. Rritja e kapaciteteve profesionale të punonjësve vendorë (menaxhim rasti, politikat e mbrojtjes, kodi i etikës, ndërhyrje e hershme, dhuna me bazë gjinore, dhuna në familje, deinstitutionalizimi, kujdesi alternativ, mbrojtja nga të gjitha format e dhunës).

O3. Zhvillimi i paketës së shërbimeve të specializuara për fëmijën dhe familjen (Shërbimet mbështetëse për fëmijën dhe familjen, Qendra Multifunksionale, shërbimi lëvizës, ndërhyrje e hershme, këshillim prindëror, etj).

O4. Parandalimi i institucionalizimit dhe promovimi i kujdesit alternativ familjar (foster/kinship), përfshi riintegrim familjar aty ku është e mundur.

O5. Përfshirja në arsim, shëndetësi dhe programe socio-ekonomike për familjet me risk, me theks te fëmijët në situatë rruge dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

O6: Zbatimi i qasjes së drejtësisë miqësore për fëmijët për të miturit në konflikt/kontakt me ligjin: parandalim, devijim nga procedurat penale kur është e mundur, menaxhim rasti ndërsektorial dhe riintegrim në komunitet/arsim.

O7. Sistemi i të dhënave dhe monitorimit.

O8. Ndërgjegjësim publik dhe angazhim komunitar (fushata, prindërim pozitiv, barazi gjinore, diversitet).

O9. Siguria dhe mbrojtja e të dhënave personale sipas ligjit dhe standardeve të UNICEF/GDPR.

❖ **Rezultatet e pritshme gjatë zbatimit**

Gjatë periudhës së zbatimit të Planit priten rezultate të matshme dhe të qëndrueshme, si:

- Rritje e aksesit në shërbime për fëmijët dhe familjet në risk, me dyfishim të mbulimit në zonat më të prekura;
- Rikthim dhe ruajtje e frekuentimit në arsim për të paktën 100 fëmijë në risk braktisjeje;
- Ulje me të paktën 40% e numrit të fëmijëve në situatë rruge;
- Riintegrim familjar i qëndrueshëm për fëmijët pa kujdes prindëror ose të vendosur në institucione;
- Trajnim i detyrueshëm për stafin dhe partnerët në fushën e mbrojtjes së fëmijëve (safeguarding/PSEA), menaxhim rasti, protokolle emergjence dhe kujdes alternativ.

Gjatë takimit pjesëmarrësit u ftuan të paraqesin rekomandimet dhe sugjerimet në lidhje me Planin për Mbrojtjen e Fëmijëve.

❖ **Rekomandimet e dhëna nga pjesëmarrësit**

Znj.D.M- Si prind, dëshiroj të theksoj rëndësinë e mbështetjes dhe zhvillimit të aktiviteteve të vazhdueshme për mbrojtjen e fëmijëve në shkolla dhe në komunitet. Mendoj se duhet të organizohen më shumë aktivitete që rrisin ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në këtë fushë. Aktivitetet edukative dhe mbështetëse që ndihmojnë fëmijët të zhvillohen në një mjedis të sigurt dhe mbrojtës janë të nevojshme për të parandaluar abuzimet dhe për të krijuar një ambient ku ata ndihen të mbrojtur dhe të kuptuar.

Takimi u mbyll me falenderim nga Pergjegjësja e Sektorit të Mbrojtjes së Fëmijëve, znj. Eralda Allushi e cila theksoi se rekomandimet e dhëna do të shqyrtohen për tu përfshirë në hartimin e Planit për Mbrojtjen Fëmijeve të Bashkisë Kamëz.

Takimi u mbyll në orën 11:40.

Bashkëngjitur Fotot:

